



**MEKANIZIMI:
PËRGATITJA PËR MBJELLJE**

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



DUART BUJQËSORE TË VLERËSUARA



**Luledielli
përsëri në
rrezik të mos
jetë në fusha**

**Kikirikët e
Strumicës po
kthehen në
fushë**



**Lule e njohur
për kopshtet
maqedonase**



**Trëndafili
i egër**

KUNGULLI -
MBRETI I VJESHTËS

6

SI TA BËNI ATË TË DREJTË
VJELJA DHE RUAJTJA

10

MEKANIZIM ME SHTYTJE
ELEKTRIKE

13

UNAZIMI I
MBRETËRESHËS

14

ENTEROTOKSEMIA
(SËMUNDJA E
MBIUSHQIMIT)
TE DELET DHE DHITË

20

FEDERATA NACIONALË
E FERMERËVE

FEDERATA NACIONALË E FERMERËVE

Adresa: rr. Prolet, nr. 10/1-1, 1000 Shkup
Tel: +389 70 216 109
e-mail: nff@nff.org.mk
uebfaqe: www.nff.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjia e Re, Pukë
Tel. +355 212 2 2412. Mob.: +355 68 23 88 169/
+355 69 57 42 060/ +355 67 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agropuka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me organizatat partnere në mbi 20 vende, me vizion të botës së qëndrueshme dhe të drejtë të çliruar nga varfëria. WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të përforcohet zëri i përbashkët i bujqve.

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FNF, AGRINET, AGROPUKA për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit në suazat e sektorit bujqësor.

FEDERATA NACIONALË
E FERMERËVE

Toka ime, Dhjetor 2023

Botues: FNF

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Prolet, nr. 10/1-1,
1000 Shkup
e-mail: nff@nff.org.mk
Udhëheqës: Stevan Orozovic

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska
Botuar më:
Dhjetor 2023

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Bashkëpunëtorë profesionale:

Prof. dr. Zvezda Bogevska, Asoc. dr. Margarita
Davitkovska, Aleksandar Uzunov, Çao Çen, Tomislav
Nikolovski, prof. Dr. Dragi Tanevski

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

Bujqësi: sfida dhe perspektiva për vitin 2024

Bujqësia në rajon po ballafaqohet me disa aspekte kritike që kërkojnë vëmendje dhe aksion

1. Ndryshimet klimatike dhe bujqësia

Ndryshimet klimatike nga viti në vit po bëhen më të dukshme dhe po ndikojnë fuqishëm mbi aktivitetet bujqësore. Temperaturat e larta, reshjet e paparashikuara të shiut, si dhe kushtet e tjera ekstreme kohore po krijojnë pasiguri në prodhimin e ushqimit. Në vitin 2024 duhet të përpilohen dhe të vendosen strategji dhe masa për përshtatje të bujqësisë me kushte e reja kohore.

2. Inovacionet teknologjike dhe digjitalizimi

Zbatimi i zgjidhjeve të reja teknologjike mund të kontribuojë theksueshëm në përmirësimin e efikasitetit dhe prodhimit në bujqësi. Institucionet dhe sektori privat duhet të investojnë në këto teknologji të përparuar që

ta lehtësojnë procesin e punës dhe të zmadhohet rendimenti.

3. Qëndrueshmëria e praktikave bujqësore

Qëndrueshmëria në bujqësi është qenësore për mbrojtjen e resurseve bujqësore dhe për ruajtjen e ekuilibrit të ekosistemit. Zbatimi i praktikave si bujqësi organike, riciklimi i bërrllokut dhe ruajtja e biodiversitetit duhet të jenë prioritet për bashkësinë bujqësore në vitin 2024.

4. Arsimi dhe mbështetja e bujqve të rinj dhe grave fermere

Bujqit e rinj dhe gratë fermere duhet të nxiten dhe të arsimohen që ta ndjekin dhe ta përparojnë bujqësinë tradicionale me ide të reja. Institucionet duhet të krijojnë programe dhe mbështetje financiare për të rinjtë dhe gratë fermere.

Në vitin 2024, bujqësia në rajon



Me respekt
Biljana Petrovska-Mitrevska
Redaktore e revistës për bujqësinë
"Toka ime"

do të jetë para shumë sfidash, por edhe hap dyer për zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme. Me përpjekje të përbashkëta të institucioneve, organizatave joqeveritare, sektorit privat dhe bashkësisë së bujqve mund të ndërtojmë bujqësi të qëndrueshme.

LUFTË E PËRBASHKËT KUNDËR COVID 19



Luledielli

përsëri në rrezik të mos jetë në fusha

Thatësira e përgjysmoi rendimentin, kurse çmimi në bursë drastik më i ulët këtë vit

Kultivimi i lulediellit në fushat maqedonase ka shumë përparësi. Për të gjitha gjërat pozitive që sjell kjo kulturë industriale vajdhënëse, që disa vite më parë nisi me motivimin e fermerëve për ta kthyer këtë kulturë në fusha. Blerësit ofruan çmime më të larta blerjeje, shteti ndërhyri me subvencione më të larta dhe u prodhuan rreth 10 mijë tonë luledielli. Por këtë vit situata është krejtësisht ndryshe. Për shkak të tepricave të vajit bruto dhe lulediellit nga Ukraina për shkak të luftës me Rusinë, çmimi i kësaj kulture ka rënë në mënyrë drastike në tregjet botërore, kurse nga ana tjetër, kushtet e pafavorshme të motit të përjetuara nga fermerët shkaktuan të merren rendimente shumë të vogla, gjë që i vendos në një pozitë të palakmueshme që të mos mund t'i kthejnë as financat e investuara gjatë vitit të prodhimit.

- Çmimi vitin e kaluar

ka qenë 35 denarë, ndërsa sivjet është 20,5 denarë i sjellë në Veles. Kjo është një rënie drastike e çmimit që diktohet nga bursat botërore dhe shohim që është edhe çmimi në vendet përreth. Prandaj besojmë se shteti tani duhet t'i ndihmojë fermerët në këtë situatë me para nga fondi intervenues nga 6 deri në 7 denarë për kilogram që të mos humbasë interesi për kultivimin e kësaj kulture shumë të rëndësishme

që dalëngadalë ka filluar të kthehet në arat tona. Unë kam 50 hektarë me luledielli dhe këtë vit me përdorimin e të gjitha masave agroteknike rendimenti im mesatar është 1.2 ton, që lirisht mund të them që është i mirë për një vit si ky kur shoh se në rajonet e tjera dhe me shumicën e prodhuesve rendimentet janë nga 600 deri në maksimum 800 kilogramë për hektar. E mbollëm lulediellin në baltë për shkak të shirave të dendur në pranverë dhe më pas u kap nga thatësira kur duhej të ishte pjekur. Krahasuar me vitin e kaluar, prodhimi është përgjysmuar, thotë Mile Kebakoski, prodhues i lulediellit nga Rajoni i Prilepit.

- Edhe pse Manastiri ka disa nga tokat më pjellore, rendimentet këtë vit për shkak të ndryshimeve klimatike janë shumë të vogla, gjithashtu edhe çmimi është i pakënaqshëm, gjë që e bën këtë prodhim joprofitabël. Për një pjesë të mad-



he të fermerëve do të jetë vendimtare nëse do të mbjellin luledielli në rotacionin e tyre, nëse nuk ka mbështetje nga shteti. Humbjet do të jenë të shumfishta sepse këtë vit do të jenë në të kuq me prodhimtarinë, por do të kenë rendiment më të ulët për grurin dhe misrin nëse e përjashtojnë lulediellin nga rrotullimi dhe e harrojnë si kulturë, tha Sasho Petrovski, prodhues luledielli nga Rajoni i Manastirit.

Një nga blerësit më të mëdhenj të lulediellit në një vit si ky kur ka rendimente të reduktuara dhe presion nga çmimet e ulëta të aksioneve, e konsideron si goditje shtesë rritjen e TVSH-së nga 5% në 10%.

- Luledielli nuk është luks dhe nuk e



di pse u rrit taksa për këtë kulturë vajore, e cila përdoret ekskluzivisht për prodhimin e vajit ushqimor, me interes strategjik për shtetin dhe fermerët. Nuk shohim asnjë logjikë që lënda e parë të taksohet me 10 për qind dhe vaji që përfitohet më tej të taksohet me 5 për qind, prandaj i bëjmë apel qeverisë që të rishqyrtojë këtë vendim. Vitin e kaluar kemi blerë 9800 tonë, kurse këtë vit vetëm 3800 tonë luledielli maqedonas. Thatësira luajti një rol të madh këtë vit dhe i vuri fermerët në një situatë të keqe, e cila u pasua nga çmimi i ulët i blerjes që diktoi konkurrencën. Në Serbi luledielli paguhej 320 euro për ton, kurse ne paguam 330 euro për ton, që ende nuk mjafton, tha Goran Lazov, drejtor ekzekutiv në Kristal Veles.

Dhe shkenca është dakord se luledielli mezi është kthyer në fushë pas shumë vitesh. Por këtë vit, kushtet e motit dhe çmimet e ulëta të blerjes kërcënojnë ta hedhin sërish në harresë.

- Luledielli është një kulturë vajore industriale jashtëzakonisht e rëndësishme. Është shumë e rëndësishme për rotacionin e të korrave që fermerët e njohin më së miri, pastaj është e rëndësishme për furnizimin e popullatës me vaj ushqimor si produkt i rëndësishëm strategjik, gjithashtu kontribuon në prodhimtarinë më të lartë të qumështit të lopët me nënproduktin e lulediellit, kurse mjalti mund të të llogaritet ndër avantazhet e shumta që marrin bletarët. Lufta në Ukrainë dhe destabilizimi i tregut, kur nuk kishte vend për të importuar vaj të parafinuar, na zgjoi pak për ta rikthyer këtë kulturë në fushë. Fatkeqësisht, kemi pasur një vit të keq nga pikëpamja klimatike e ndjekur nga një thatësi e gjatë dhe kjo kulturë, megjithëse është



më rezistente ndaj kushteve të thatësisë, në faza të caktuara nëse nuk ka reshje shiu duhet të ketë dy ujitje, të cilat, për fat të keq, në vendin tonë vështirë se dikush mund t'i sigurojë për shkak të mbulimit të dobët me sisteme vaditëse. Ndoshta nuk duhet të harrojmë edhe kulturat e tjera vajore siç është rrepka vajdhënëse e cila jep rendimente më të larta dhe ka çmim më të lartë blerjeje që mund të kërkohet ndryshim në shprehite e konsumatorit për ta pasur atë si zëvendësim të lulediellit, tha profesori Zoran Dimov nga Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit nga Shkupi. ●



Kungulli - Mbreti i vjeshtës



Foto 1.
Lloje të ndryshme kungujsh

Në Amerikën qendrore kungulli është një nga ushqimet kryesore të qytetërimeve të lashta

Autori: Prof. dr. Zvezda Bogevska -
FAKULTETI I SHKENCAVE BUJQËSORE
DHE USHQIMIT, UKEM

Kungujt përfshijnë një numër të madh specimesh që janë kultivuar shumë kohë më parë (Foto 1). Ata e kanë prejardhjen nga Amerika Qendrore dhe, së bashku me misrin, ishin ushqimi kryesor i qytetërimeve të lashta (Inkas, Majans dhe Azteks). Ata u sollën në Evropë pas zbulimit të Amerikës.

Varietetet e kultivuara të kungujve u përkasin kryesisht këtyre tri llojeve bazë: Cucurbita pepo L. - kungulli i zakonshëm (Foto 2), Cucurbita maxima Duch. - kungull misër (Foto 3) dhe Cucurbita moshata Poir.- kungull muskat ose sheqer (Foto 3).

Këto tri lloje kungujsh ndryshojnë nga njëri-tjetri nga një sërë karakteristikash morfologjike, si në organet vegjetative ashtu edhe ato gjeneruese. Dallimet ekzistojnë në kërcellin, gjethen, pjesa me push, kërcellin e frutave, formën e



Foto 2. Kungulli i zakonshëm



Foto 3. Kungull misri

frutave, mezo-karpinën (pjesën e mish) dhe farën. Shenja më karakteristike me të cilën mund të dallohen llojet individuale të kungujve është kërcelli i frutave (Tabela 1).



Foto 4. Kungull muskat

Nga të gjitha llojet më shumë kultivohet kungulli i zakonshëm, kryesisht për ushqimin e bagëtive, kungujt për përgatitjen e gjellëve të ndryshme për konsum njerëzor dhe në një masë më të vogël kultivohet kungulli misër, kungulli muskat etj. Me kungujt, frutat e pjekurisë së ndryshme përdoren për ushqim, menjëherë pasi frutat janë ngurtësuar, për përgatitjen e zierjeve të ndryshme, sallatave, pjekje dhe zierje, marinim, turshi dhe tharje. Kungulli misër dhe kungulli muskat, ose arrëmshk përdoren ekskluzivisht në pjekurinë fiziologjike si i pjekur dhe i zier për përgatitjen e ushqimeve të ndryshme, veçanërisht për fëmijët, por edhe për përgatitjen e reçelrave, mar-melatave dhe produkteve të thata.

Tabela 1. Karakteristikat morfologjike të llojeve të ndryshme të kungujve

Shenja morfologjike	Cucurbita pepo L.	Cucurbita maxima Duch.	Cucurbita moshata Poir.
Trungu	i mprehtë, trekëndësh, me brazda	cilindrik	këndor
Gjethja	pesë pjesësh	Formë veshke	I prerë me pjesë që arrijnë deri në nervin kryesor
Pushi	gjemba të mprehta	qime të holla	qime të holla
Kërcelli i frutës	prizmatik, me brinjë të mprehtë	cilindrik, i lëmuar, мазна	Me brazda, i zgjeruar në bazë
Forma e frutës	e rrafshuar, e rrumbullakët ose cilindrike	e rrafshët	e zgjatur, fruta ngushtohet në mes
Tuli i frutës	me qime	i brishtë dhe i lëngshëm	e fortë, i lëngshëm
Fara	e bardhë në të bardhë në gri me teh të lëmuar	e madhe, e lëmuar me teh të trashë, portokalli	e bardhë në gri

Nga farat merret vaj ushqimor shumë cilësor.

Kungujt janë bimë të klimës së ngrohtë. Temperatura optimale për rritjen e organeve vegetative është rreth 25°C, për formimin e organeve gjeneruese rreth 25-27°C. Ndalon rritjen dhe zhvillimin në temperaturë nën 15°C, humb në -1°C. Kungujt janë bimë tipike heliofile, edhe pse mund të tolerojnë hije të lehta kur rriten si një kulturë e përbashkët në kombinim me fasulet dhe misrin. Sipas strukturës së organeve vegetative, kungujt janë shumë të ndjeshëm ndaj mungesës së ujit. Lagështia e tokës gjatë gjithë vegetacionit duhet të jetë konstante dhe rreth 80% e PVK, ndërsa lagështia e ajrit duhet të mbahet në nivelin 70%. Rezultatet më të mira arrihen kur rriten në toka të ngrohta, strukturore, pjellore me kullim të lehtë, me përmbajtje të lartë të lëndës organike. Kërkon ekspozim



jugor. Në rotacionin e të korrave të kopshtit, vijnë të parët dhe nuk tolerojnë kultivimin në monokulturë. Kungujt nuk duhet të rriten kurrë në të njëjtën parcelë menjëherë pas një kulture tjetër nga e njëjta familje kurse në të njëjtin vend vetëm pas 4 vjetësh. Kungujt rriten me të njëjtin sukses me mbjellje të drejtpërdrejta ose me paraprodhim të fidanëve. Mbjellja ose mbjellja në

botanikisht (përveç kungujve) me shenja të humbjes së shkëlqimit në sipërfaqen e frutave dhe me kërcell të tharë pranë frutave.

Frutat mbledhen me një gjatësi të kërcellit të frutave 2,5 cm. Kungujt paktohen në qese rrjetë, madhësi dhe formë sipas kërkesave të konsumatorit. Peshë neto e qeseve rrjetë nuk duhet të kalojë 23kg.



vend të hapur ndodh kur toka është ngrohur mjaftueshëm, domethënë nga fundi i prillit, por më mirë nga mesi i majit. Kungujt me kërcell të poshtëm mbillen në një distancë prej 2 x 1 m ose 3 x 1 m me dy bimë në një vatër. Kungull i njomë mbillet në një distancë prej 120-150 x 60-80cm. Shpesh në një vatër mbillen 4-5 fara dhe më vonë lihen 2-3 bimët më të zhvilluara. Për 1 ha nevojiten 3-5 kg farë. Gjatë vegjetacionit, bëhet rrallimi, tharja, ujitja, ushqyerja dhe mbrojtja e rregullt nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Kungujt mbledhen kur frutat janë pjekur

Gjithashtu, për paketimin e kungujve përdoren pllaka fibër njësh-tresore ose dyshtresore me ndarje të brendshme. Për periudhën sa më të gjatë të marketingut, për të ruajtur cilësinë, kungujt ruhen në 12-13°C. Temperaturat më të ulëta ndikojnë në humbjen e aromës-shijes si dhe dëmtimet në formën e dhëmbëzimit të frutave të prirur për kalbje. Lagështia optimale relative e ajrit duhet të jetë 60% ose brenda intervalit 50 deri në 70%. Kungulli i njomë ruhet në temperaturë 5 deri në 10°C dhe lagështia relative 95%. ●

Kikirikët e Strumicës po kthehen në fushë

Në Novo Sellë në 20 hektarë kultivohet kikirikët e imët të Strumicës brend i njohur për këtë rajon

Në grupin e kulturave të harruara deri vonë futeshin edhe kikirikët e Strumicës. Ky prodhim ishte në prag të zhdukjes së plotë për shkak të nevojës për punë që po bëhet gjithnjë e më pak e disponueshme, si dhe për shkak të metodës specifike të kultivimit. Por entuziastët që vendosën të angazhoheshin në prodhimin bujqësor në mënyrë profesionale në kërkim të një kulture bujqësore autoktone në rajonin e tyre, vendosën të angazhoheshin seriozisht në prodhimin e kikirikut. Cvetanço Gjorgjiev nga Novo Sella e Strumicës gjatë gjithë jetës së tij është marrë me bujqësi. I pajisur me makineri moderne për të gjitha operacionet e nevojshme prodhuese, ai vendosi disa vite më parë t'i përkushtohej prodhimit të kikirikëve, diçka që është pothuajse në prag të zhdukjes në këtë rajon dhe ku është në dispozicion është në zona shumë të vogla



- Ideja është që të rikthehet shkëlqimi i një marke tashmë ekzistuese për këtë rajon me qëllimin kryesor ruajtjen e prodhimit të farës së vjetër të kikirikut që është shumë mirë i përshtatur me klimën tonë. Maqedonia është e varur nga importi i arave, ndaj më duket interesant kthimi i kikirikut të vogël të Strumicës, i cili ka aromë specifike dhe shije të këndshme. Vitin e parë nuk arritëm të merrnim farë të mjaftueshme, kështu që na u desh të punonim dy vjet rresht për të prodhuar farë të mjaftueshme. Tani jam në vitin e tretë të prodhimit dhe kultivoj kikirikë në 20 hektarë, nga të cilat pres 15-20 tonë prodhim me shpresën se në sezonin

e ardhshëm do të kemi shumë më tepër sepse më së shumti varet nga kushtet atmosferike, - tha Cvetanço Gjorgjiev, fermer nga Novo Sella.

Kikirikët si kulturë janë specifike për kultivim dhe teknologjia e prodhimit dhe masat e nevojshme agroteknike në një korrije janë diçka që duhet mësuar gjatë prodhimit sepse askush nuk e ka bërë këtë lloj kultivimi më parë. E gjithë eksperiencia bujqësore që mund të mblidhte nga të moshuarit lidhet me mënyrën manuale të bujqësisë në sipërfaqe të vogla, diçka që në ditët e sotme me tregje të hapura dhe kikirikë të importuar me çmime të ulëta do ta bënte të padobishme nëse nuk do të kultivohej në sipërfaqe më të mëdha.

- Kjo që po bëjmë është kultivimi për herë të parë i mekanizuar i kikirikëve të Strumicës, për të gjithë procesin e punës duhet të kemi mekanizim që të mund të kultivojmë edhe kikirikë në sipërfaqe të mëdha. Por në një kohë kur mungesa e fuqisë punëtore është një problem i madh, na u desh të investonim në blerjen e makinerive për mekanizim të plotë, për të cilat ka makineri në botë. Ne i vlerësojmë njohuritë nga të moshuarit që kultivonin kikirikë,



por megjithatë ka disa dallime. Tani me këto sipërfaqe të mëdha dhe me tre vjet kultivim, mund të themi se i kemi zbuluar të gjitha sekretet e këtij prodhimi, shton Gjorgjiev.

Bima duhet të njihet dhe t'i jepet gjithçka ashtu siç duhet sepse edhe një gabim i vogël në një zonë të tillë mund të thotë shumë për produktivitetin dhe përfitimin.

- Si të gjitha bishtajoret, edhe kikirikët janë fiksues të azotit, domethënë janë në gjendje të ruajnë azotin nga ajri në rrënjë në tokë. Por për ta, ai azot është akoma toksik nëse riprodhoni kikirikë në të njëjtat zona. Kjo është arsyeja pse është jashtëzakonisht e rëndësishme të zbatohet rotacioni i duhur i të korrave, domethënë të mbillet një kulturë që do ta konsumojë atë azot në tokë pas kikirikëve. Për të pasur një rendiment të mirë, kikirikët kanë nevojë për më shumë minerale si kalcium, magnez, stroncium etj., në mënyrë që të formojnë një kikirikë të shëndetshëm në rizomën e saj, e cila do të ketë arra të shëndetshme. Ke ne shpesh ngatërrohet termi rrënjë me rizomë. Rrënja është pjesë e veçantë, si në të gjitha bimët, nëpërmjet së cilës nxirret uji dhe lëndët ushqyese të nevojshme. Si kulturë nuk i pëlqen shumë uji, por nuk i pëlqen as shumë mungesa e

lagështirës. Megjithatë, është e nevojshme të dihet se kur dhe si të shkaktohet një lloj stressi që do të iniciojë bimën të lëshojë rizoma në pjesën sipërfaqësore të tokës ku formohen

bishta -
jat në
të cilat
rriten
kikirikët.

Kikirikët i pëlqejnë tokat e shkrifëta dhe e pëlqejnë prashitjen mjaft të mirë ndërmjet rreshtave, pa praninë e barërave të këqija. Këtu nuk ka nevojë të blini fara, por ato rimbillen. Vitin e parë bleva farë nga një burrë nga fshati Borisovë, për të cilin më theksuan se e kishte ruajtur farën e vjetër dhe me të mbolla një sipërfaqe prej një hektari, kështu që i përdorëm të gjitha farat për vitin e dytë, kur kishim 1.5 ton për të shitur dhe tashmë këtë vit presim 15-20 tonë për shitje. Nëse gjithçka shkon ashtu siç duhet, rendimenti duhet të shkojë nga 1.5 ton për hektar dhe kemi arritur mesatarisht një ton për momentin, shton Gjorgjiev.

Ky vit nuk ishte i favorshëm për pothuajse të gjitha prodhimet bujqësore, duke përfshirë edhe prodhimin e kikirikut. Ka pasur shumë shi gjatë periudhës së mbjelljes dhe më pas ka pasur një thatësi të zgjatur.

- Këtë vit patëm një problem me të cilin u përballëm sepse shirat e dendur shkaktuan formimin e një kore në vetë tokën, e cila kërcënoi të parandalonte mbirjen e sukseshme të kikirikëve të mbjellë, për të cilën na u desh të blinim shpejt një makinë dhe ta kapërcenim këtë problem. Pasi mbiu, në maj dhe qershor kishim shumë shi dhe toka ishte lagur, e më pas duhej të vaditeshim dhe të ishim vazhdimisht të pranishëm në sipërfaqe për të monitoruar sëmundjet, insektet dhe në fund baldosat dhe derrat e egër. Ajo që është sfiduese për sipërfaqe të mëdha është vjelja e frutave. Ne kemi një makinë që nxjerrë bimët dhe i lë ato me kokë poshtë në fushë në një rresht të vetëm pas me kikirikët lart që të thahen natyrshëm në parcelë. Më pas kemi marrë një vjelëse të zvarritur që i ndan kikirikët nga bima dhe më tej kalojnë në tharje shtesë e cila zakonisht shkon në një serë ku ka temperaturë dhe rrymë dhe në fund përpunohen në një makinë vibruese që ka një sistem kullimi dhe pastri mi që të mund të dalin në shitje të pastër, tha Gjorgjiev.



Plasmani i kikirikëve nuk është problem dhe kërkesa më e madhe është në muajt e dimrit, kur është periudha e agjërimit dhe kreshmës dhe më pas çdo shtëpi blen kikirikë. Prodhimi aktual maqedonas ende nuk i plotëson as 2% të nevojave. Nëse problemi me prodhimin tjetër bujqësor është plasmani, kjo është kulturë që mund të qëndrojë për një periudhë të caktuar dhe të presë për plasman. Ndoshta në të ardhmen do të mendohet për marrëdhënie bashkëpunimi për përdorimin e këtyre makinerive të blera, por problemi i madh janë parcelat e vogla që tradicionalisht janë të pranishme në rajonin tonë. Blloku duhet të jetë mbi një hektar në mënyrë që makineria të funksionojë që të mos ketë shumë humbje.

- Planet janë që të rriten më tej sipërfaqet me kikirikë deri në 50%, sepse sa më të mëdha të jenë sipërfaqet, aq më të larta janë fitimet dhe kthimi nga investimi në numrin e madh të makinerive.



Tharja është operacioni më i rëndësishëm në teknologjinë e qepës pas vjeljes. Ajo zvogëlon humbjet pas vjeljes dhe humbjet e lagështisë duke hequr lagështinë e tepërt nga lëvozhga e jashtme e jashtme dhe qafa e të korrave të freskëta në një nivel që do të minimizojë humbjet e brendshme dhe rrudhat dhe do të çojë në një reduktim të infeksionit mikrobik. Nëse tharja kryhet në fushë, temperatura nuk duhet të jetë më e ulët se 24°C. Përveç tharjes natyrale, praktikohet edhe tharja e detyruar me ajër. Rezultatet më të mira arrihen në një temperaturë prej rreth 38°C dhe një lagështi relative jo më të lartë se 80% për një periudhë rreth një jave.



Si ta bëni a VJELJA DH



Shkruan: as. dr. Zvezda Bogoevska,
as. dr. Margarita Davitkovska

Si te të gjitha kulturat e perimeve, korrja dhe ruajtja janë të rëndësishme për qepët. Fermerët duhet t'i kushtojnë vëmendje vjeljes së qepëve në mot të thatë, sepse nëse bie shi ose kur lagështia është e lartë, rritet ndjeshmëria ndaj sëmundjeve pas vjeljes. Në momentin e vjeljes, bishtajat duhet të jenë të forta, me qafë të mbyllur të pjekur dhe me lëvozhgë mbuluese dhe me dimension (madhësi) të përshtatshme. Gjatë korrjes, duhet të hidhen kokrrat e dëmtuara (e dëmtuara nga insektet, me djegie, të papjekura dhe të dëmtuara).

Sipas disa studimeve, nëse përqindja e kërcellit të rremë të kalbur është 20-50%, depërtimi gjatë ruajtjes zvogëlohet, por për këtë arsye të ardhurat totale zvogëlohen me 15% në krahasim me vjeljen kur përqindja e kërcellit të kalbur është 80%. Rezultatet e hulumtimeve të tjera kanë treguar se korrja mund të vonojë deri në 100% maturimin pa rritur humbjet e marketingut gjatë ruajtjes ose duke ulur cilësinë gjatë afatit të ruajtjes. Megjithatë, në praktikë, pranohet që vjelja të kryhet kur 50-80% e masës mbetë tokësore të jetë shtrirë mbi truall.

Qepa mbledhet manualisht ose mekanikisht. Vilet me dorë me rrënjë, ndërsa vjelja e mekanizuar zakonisht bëhet në dy faza (së pari hiqet qepa dhe lihet në shirita të thatet

RUAJTJA E RREGULLT

Kushtet e ruajtjes. Temperatura optimale është 0-2°C, kurse lagështia relative 65-70% (varg 65-80%). Ftohja e shpejtë nuk kërkohet. Nëse dëshironi të mbani qepën për një kohë më të gjatë, atëherë është e nevojshme që të ulni temperaturën në nivelin e kërkuar sa më shpejt. Gjatësia e ruajtjes. Në kushte të temperaturës dhe lagështisë optimale, qepët mund të ruhen me sukses nga

1-8 muaj në varësi të varietetit. Pika e ngrirjes: -0,8°C. Atmosferë e kontrolluar. Në kultivarët me potencial të gjatë ruajtjeje, nuk u vu re asnjë përfitim nga aplikimi i një atmosfere të kontrolluar. Kokrrat mund të dëmtohet nëse përmbajtja e oksigjenit në atmosferën e ruajtjes është nën 1% dhe përmbajtja e oksidit të karbonit IV është mbi 10%. Përdorimi komercial i një atmosfere të kontrolluar prej 3% O₂ dhe 5-7% CO₂ rekomandohet për ruajtjen e varieteteve të qepëve të ëmbla me potencial të ulët ruajtjeje.



të të drejtë E RUAJTJA

ÇRREGULLIME GJATË RUAJTJES

Mbirja është problemi më i madh gjatë ruajtjes dhe shkakton humbjet më të mëdha. Me zbatimin e kushteve të rekomanduara zvogëlohen problemet, p.sh. humbjet gjatë ruajtjes. Gjatë ruajtjes, mund të shfaqet një çrregullim fiziologjik - luspave të ngjashme me melin, të cilat u shfaqën për herë të parë në Evropën Veriore. Vetë procesi i formimit të luspave quhet teoria e mbyrtjes. Vjeljet e vona, temperaturat e larta për tharje apo përpunim, si dhe tharja e zgjatur janë arsyeja e shfaqjes së luspave.

Për të shmangur çrregullime të tilla fiziologjike, rekomandohet:

- korrje e hershme (jo më vonë se 50-80% e uljes së masës nëntokësore);
- trajtimi i kujdesshëm i kokrrave;
- të shmanget korrja në mot të lagësht;
- tharja duhet të kryhet në kuti dhe jo në pirqje të larta për të shmangur trysinë;
- temperatura e tharjes duhet të jetë më e ulët se 25°C (temperatura të tilla të larta rekomandohen për ngjyrosje më të errët të lëvozhgave të thata mbuluese).



5-10 ditë dhe më pas mblidhet dhe çohet në ruajtje).

Tharja është operacioni më i rëndësishëm në teknologjinë e qepës pas vjeljes. Kjo zvogëlon humbjet pas vjeljes dhe humbjet e lagështisë duke hequr lagështinë e tepërt nga lëvozhga e jashtme dhe qafa e të korrave të freskëta në një nivel që do të minimizojë humbjet e brendshme dhe rrudhat dhe do të çojë në një reduktim të infeksionit mikrobik. Nëse tharja kryhet në fushë, temperatura nuk duhet të jetë më e ulët se 24°C. Përveç tharjes natyrale, praktikohet edhe tharja e detyruar me ajër. Rezultatet më të mira ar-

rihen në një temperaturë prej rreth 38°C dhe një lagështi relative jo më të lartë se 80% për një periudhë rreth një jave.

Tharja zvogëlon masën e kokrrave dhe duke qenë se ato shiten kryesisht në bazë të masës së tyre, aritja e nivelit të dëshiruar të dehidrimit është kritike. Humbjet në masë prej 3-5% janë normale në kushtet e tharjes në ambient dhe deri në 10% në tharjen artificiale (të detyruar).

Në Angli, fluksi i ajrit në 26-28% gradë është përdorur që nga viti 1975 për të tharë qepën. Është

e nevojshme të hiqni lagështinë e tepërt në tri ditë. Më pas qepa thahet në 25°C për 3-4 orë në ditë, derisa qafa të thahet. Pastaj temperatura ulet dhe mbahet në 0°C në magazinat e ftohta. Sistemet moderne të tharjes kanë një kapacitet prej 2000 t.

Gjatësia e fazës së fjetur varet nga varieteti, që do të thotë se sukcesi i ruajtjes varet nga varieteti. Më mirë mbahen varietetet me një numër më të madh gjethesh të mbyllura me lëng, një numër më të madh gjethesh të thata, me më shumë se 14% lëndë të thatë (varietetet djegëse) dhe disakaride. Varietetet me një periudhë të shkurtër prehje mbahen më shkurt dhe kanë një përmbajtje të lëndës së thatë nën 10% (varietetet e ëmbla) dhe e kanë origjinën nga gjerësia gjeografike jugore.

Erën e qepëve e marrin shpesh edhe produkte të tjera në mjedis, ndaj preferohet që të mbahen veçmas, me përjashtim të disa kulturave që lidhen me to si hudhra. Gjatë pastrimit, qepa pastrohet nga gjethet e thata të tepërta dhe qafa duhet të pritet në një gjatësi prej 2 cm. ●

Lule e njohur për kopshtet maqedonase

Shkruan: Asoc. dr. Margarita Davitkovska,
asistente dr. Zvezda Bogoevska

Kumaku njihet si një nga lulet më të zakonshme në kopshtet maqedonase. Ngjall ndjesi të këndshme gjatë kujtimeve dhe lojërave të fëmijërisë në kopshtet e bukura të gjysheve tona me kumak (lule kadife) të verdhë dhe portokalli.

Emri latin i kumakut është *Tagetes sp.* Llojet e gjinisë *Tagetes* e kanë origjinën nga zonat tropikale të Amerikës dhe u sollën në Evropë në shekullin e 16-të. Gjinia *Tagetes* i përket familjes *Asteraceae*.

Përhapja e kumakut bëhet me farë. Prodhimi i fidanëve bëhet në shtretër të ftohtë në fund të marsit ose në fillim të prillit. Fidanët janë të ndjeshëm ndaj temperaturave të ulëta dhe për këtë arsye mbjellja në natyrë bëhet në muajin maj, kur nuk ka rrezik për ngrica. Bimët mbillen në një distancë prej 20-60 cm, në varësi të lartësisë së kërcellit. Lulëzimi fillon 60-70 ditë pas mbjelljes.

Kumaku rritet lehtë sepse toleron thatësinë dhe rrezet e diellit me intensitet të lartë. Por mund të rritet edhe në hije të pjesshme. Cilësia e tij rritet me ushqim shtesë dhe ujtitjen e rregullt.

Kumaku përdoret gjerësisht. Varietetet e ulëta përdoren për të bërë kufij lulesh, ato mesatare-të larta përdoren për të formuar shtretër lulesh dhe ato të larta përdoren për të formuar grupe lulesh dhe si lule të prera. Ato përdoren edhe si lule ballkoni.

KARAKTERISTIKAT

Llojet e gjinisë *Tagetes* formojnë një kërcell të degëzuar dendur, me gjethe me dhëmbëza dhe të prera thellë. Lulet janë në formë tubore dhe tabelare, të mbledhura në tufë lulesh në formë koke, me ngjyrë të verdhë, portokalli ose të kuqe-kafe. Lulëzimi zgjat gjatë verës, deri në ngricat e vjeshtës. Në florikulturë, speciet më të rëndësishme janë *Tagetes erecta L.*, *Tagetes patula L.* dhe *Tagetes signata Bartl.* Prej tyre, ka varietete të shumta që ndryshojnë në lartësinë e bimëve (nga 20-100 cm), si dhe në madhësinë e lulëzimit.



Tagetes erecta L.



Tagetes patula L.



Tagetes signata Bartl.

Mekanizim me shtytje elektrike

Sa do të presim që të fillojë prodhimi në seri dhe zbatimi i gjerë në bujqësi

Llojet të caktuara të makinerive bujqësore lëvizin prej kohësh me shtytje elektrike. Por do ta gjejmë traktorët elektrikë zbatimin praktik apo do të mbeten vetëm ëndërr e inxhinierëve? Ferma e së ardhmes shqyrtoi teknologjitë e reja dhe aplikimin e tyre. Hyn në traktor, e ndez dhe ka heshtje, por nuk ka vend për shqetësim apo për të kontrolluar menjëherë nën kapuç për ndonjë defekt, por duhet përvoja e një traktoristi që do të përdorë një traktor elektrik në të ardhmen. Sot është e mundur të merrni një ushqyes ose ngarkues me një makinë elektrike që nuk lëshon asnjë gaz të dëmshëm në fermë gjatë kryerjes së detyrave të caktuara me to. Përveç kësaj, nëse burimet e rinovueshme të energjisë përdoren për të karikuar bateritë, atëherë emetimi i gazrave të dëmshëm zvogëlohet më tej. Fuqia e këtyre makinerive me bateri është një zgjidhje praktike, pjesërisht për shkak të forcës së ulët që kërkohet për të lëvizur këto makineri dhe pjesërisht për shkak të përdorimit të rastësishëm që u jep atyre hapësirë dhe kohë për të rimbushur bateritë, ndryshe nga traktorët që duhet të jenë gati për të punuar, për detyra të rënda në parcela ndonjëherë gjatë gjithë ditës që është e vështirë për t'u kapërcyer në raport me motorët me naftë.



SHTYRJE ELEKTRIKE

Përfaqësuesit e këtij burimi energjie besojnë se situata mund të kthehet në favor të tyre nëse industritë e mëdha të makinave vazhdojnë me investimet në automjete elektrike. Ata besojnë se nëse do të ketë një zhvillim të sistemeve të baterive për sa i përket kohëzgjatjes më të gjatë dhe kohës më të shkurtër të karikimit, i gjithë ky segment do të përparojë dhe çmimi do të fillojë të ulet, gjë që do t'i bëjë ato më të përballueshme.

Furnizuesi vetëlëvizës TMR tashmë funksionon me 100% energji elektrike, gjë që lejon kosto më të ulëta funksionimi dhe mirëmbajtjeje në krahasim me një traktor me naftë. Kjo është veçanërisht e theksuar në fermat që kanë instaluar fotovoltaike në çatitë e tyre ose përdorin burime të tjera të rinovueshme të energjisë. Ky furnizues i boshtit të përparmë ka një motor elektrik 18 kilovat i cili është i mjaftueshëm për të drejtuar deri në 25 km/h dhe një motor tjetër elektrik 15 kilovat për të drejtuar rrotullën në mikserin e ushqimit, i cili është dëshmuar se ka fuqi të mjaftueshme për të shtypur rotobalet dhe për të prodhuar një përzierje homogjene në të. Një karikim i baterisë është i mjaftueshëm për tri përzierje për një fermë me 100 lopë qumështore me opsionin e baterive shtesë që mund të sigurojnë funksionim për pesë përzierje në ditë. Prodhuesit e këtij lloji të ushqyesve elektrikë TMR parashikojnë fillimin e prodhimit komercial në periudhën 2019-2020.



Unazimi i mbretëreshës

Metodë alternative për ndërprerjen e shtratit të familjet e bletëve

Autorë: Aleksandar Uzunov - Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit Shkup
Cao Cen - Laboratori Kryesor Shtetëror i Insekteve, Instituti i Bletarisë dhe Kërkimeve, Akademia Kineze e Shkencave Bujqësore, Pekin, Kinë.

Ndërgjegjësimi i konsumatorëve për përfitimet nga produktet e sigurta të bletëve ka nxitur sektorin e bletarisë dhe komunitetin shkencor që të eksplorojnë së bashku alternativa ndaj trajtimeve kimike konvencionale për kontrollin e Varroas, të cilat sigurisht mund të kontaminojnë produktet e kosheres me vlerë të lartë. Kjo prirje, veçanërisht e dukshme gjatë dekadës së fundit, nxiti më shumë kërkime në terren dhe praktike, ku në luftën kundër Varroas u pohan dhe u përhapën veçanërisht metodat bioteknike. Nga opsionet e disponueshme të metodave bioteknike, duket se metodat e ndërprerjes së pjelljes, si dhe veçanërisht metoda me mbylljen e mbretëreshës në kafaz, kanë një potencial të konsiderueshëm për t'u integruar në operacionet e rregullta të bletarisë (Uzunov et al., 2023). Praktiki i metodës së mbretëreshës në kafaz dhe thjeshtësia e aplikimit janë faktorë kyç në popullaritetin e dukshëm të barabartë midis hobistëve, bletarëve të shkallës së vogël dhe bletërritësve komercialë.

A OFRON LINDJA ZGJIDHJE ?

Një zgjidhje e mundshme për sfidat praktike të identifikuara vjen nga Kina, ku bletarët arrijnë rezultate pozitive duke përdorur një "pajisje" të thjeshtë si tub plastik, pra një unazë, për të mbuluar barkun d.m.th. barkun e mbretëreshës (figura 2).

Ky produkt i disponueshëm në treg parandalon lëvizjet e nevojshme të barkut të mbretëreshës për të vendosur vezë në qeliza. Kur përdorni unazën e frenimit të mbretëreshës për të vendosur vezë, ajo nuk pengon lëvizjen e

mbretëreshës nëpër zgjua. Emri jozyrtar i unazës 蜂王产卵节制套 mund të përkthehet "Pajisje kontracepcioni" ose "tub kontracepcioni" madje edhe "Kontrollues i pllenimit". Megjithatë, duke marrë parasysh aftësinë dhe teknikën e vendosjes së unazës, ne sugjerojmë termin "Unazë Mbretëreshë". Jozyrtarisht, bletarët kinezë kanë përdorur teknikën e unazës së mbretëreshës për më shumë se një dekadë. Është gjithashtu interesante që disa bletarë e shohin unazimin e mbretëreshës si një metodë dhe zgjidhje të



Figura 2. Mbretëresha (*Apis mellifera*) me unazë të vendosur në barkun e saj




Figura 3. Anët e jashtme (a) dhe të brendshme (b) të unazës me hapje të ngushtuara dhe më të gjera dhe seksionin gjatësor. Piskatore plastike me një unazë të zgjeruar (c) dhe (d) pamje anësore të dados me unazën e montuar. Vini re skajin e mprehtë dhe mbetjet plastike gjatë fabrikimit në pjesën e jashtme të unazës (shigjeta).

mundshme për të parandaluar që mbretëreshat të luftojnë njëra-tjetrën në përpjekje për të rritur më shumë mbretëresha në një familje (Li, 2006). Në çdo rast, prodhuesit e kanë bërë të qartë se qëllimi kryesor i unazës është të parandalojë vezëzimin e mbretëreshave për të nxitur ndërprerjen e detyruar të pjelljes. Megjithatë, duke marrë parasysht kushtet klimatike në Pekin, disa bletarë përdorin teknikën e unazimit të mbretëreshave nga fillimi i tetorit deri në fillim të marsit për pushim të zgjatur të pjelljes si një masë kontrolli të Varroas duke imituar gjendjen dhe kushtet e disa rajoneve veriore. Vetë qasja gjithashtu ndihmon në kontrollin e parazitit *Tropilaelaps* (Luo et al., 2011, personal communication with Luo, Q. H.).

Është e qartë që për t'u marrë me rriqrat në periudhën e dimrit, bletarët përdorin taktika të ndryshme në kombinim me ndërprerjen e pjelljes në koloninë e bletëve. Qasje të tilla janë përshtatur mirë me kushtet mjedisore, dhe është e mundur që ato të kombinohen me përdorimin e acaricideve të ndryshme. Nga ana tjetër, bletarët zakonisht nuk e praktikojnë unazimin e mbretëreshës si metodë verore (më të shkurtër ose më të gjatë), sepse ndonjëherë mund të shfaqen mbretëresha, të cilat kërkojnë aktivitete dhe angazhim shtesë. Megjithatë, ky aspekt intrigues i metodës është nën hetim (Uzunov et al., në përgatitje). Gjëja më e rëndësishme për t'u theksuar është se për shkak të shumëllojshmërisë së gjerë të kushteve mjedisore në Kinë, si dhe kushteve të bletarisë, unazimi i mbretëreshës përdoret në stinë, rrethana dhe praktika të ndryshme.

DIZAJNI I UNAZËS

Unaza është një lloj koni i zbrazët i bërë prej plastike të cilësisë së lartë që ngjitet rreth pjesës së përparme (kraniale) të barkut të mbretëreshës. Tubi është i hapur në të dy skajet ku njëra hapje është më e gjerë dhe tjetra më e ngushtë. Fundi më i gjerë (i cili shkon rreth qendrës së barkut të mbretëreshës) është plotësisht i hapur dhe ka një diametër të brendshëm prej afërsisht 5.8 mm (Figura 3). Fundi më i ngushtë ka një hapje drejtkëndore 3×2 mm që shkon rreth bishtit të gjetes së mbretëreshës (lidhja midis kraharorit dhe barkut) gjatë futjes. Dy hapjet lidhen me një prerje gjatësore që lejon unazën të zgjerohet. Për vendosjen e unazës, ekzistojnë piskatore plastike të dizajnuara posaçërisht (Figura 3c), të cilat disa bletarë i zëvendësojnë me piskatore standarde (laboratorike), por pak të përshtatura. Vlen të përmendet se unazat e disponueshme në treg ndryshojnë nga cilësinë e materialit, nga prodhimi i tyre dhe nga përpunimi përfundimtar i tyre. Produktet me cilësi të mirë janë më të përshtatshmet për përdorim, veçanërisht ato pa tehe të mprehta ose mbetje plastike gjatë prodhimit (Figura 3, (a) shigjeta).

MUNDËSITË E METODËS

Në krahasim me metodat e tjera bioteknike dhe metodat e ndërprerjes së pjelljes, përveç kontrollit të Varroas, unaza e mbretëreshës mund të jetë e dobishme për përdorim në aspekte të tjera praktike të bletarisë. Për më tepër, metoda nuk përfshin pajisje dhe mjete të shtrenjta dhe është e thjeshtë për sa i përket aplikimit të saj të përgjithshëm. Çmimet e kafazeve të mbretëreshave të disponueshme

në treg mund të variojnë nga 0.3 në 12 EUR, ndërsa çmimi për 100 unaza është nga 0.5 në 1.2 EUR. Përsëri, në krahasim me mbylljen e mbretëreshës në kafaz, unazimi është i thjeshtë dhe i shpejtë (veçanërisht kur praktikohet mirë) dhe më pak shkatërrues, madje edhe më i pastër se teknika e montimit në kafaz. Unaza mund të ketë potencial të madh praktik duke "digjitalizuar" teknikën duke i bashkangjitur një mikroçip unazës. Metoda madje mund të thjeshtohet nëpërmjet përdorimit të një unaze (bio) degradueshme, për të shmangur hapin e heqjes. Nga pikëpamja biologjike, unazimi i mbretëreshës duket të jetë sërish në avantazh, sepse, ndryshe nga zona e kufizuar e lëvizjes në shumicën e metodave të ndërprerjes së pjelljes, mbretëresha lëviz lirshëm në të gjithë hapësirën e kosheres. Në rrethana të tilla, mbretëresha shpërndan feromonet e saj për të ruajtur homeostazën në koloni, duke reflektuar kushtet natyrore në koloni, kurse ndryshe nga metodat e tjera, supozohet se me këtë metodë mbretëresha merr më shumë vëmendje dhe kujdes nga bletët "shoqëruese". Përveç kësaj, lëvizja e lirë e mbretëreshës brenda kosheres, e cila është përparësia kryesore e kësaj teknike, hap mundësinë për të eksploruar qasje të reja në lidhje me ndërprerjen e mbeturinave, veçanërisht në lidhje me metodat e mbylljes në kafaz dimëror, të cilat paraqesin rrezik për shkak të kufizimit të lëvizshmërisë së mbretëreshës. Me unazimin e mbretëreshës, ajo sfidë kapërcehet, mbretëresha ndjek lehtësisht klubin e dimrit dhe rreziqet e mundshme të humbjes ose eliminimit të mbretëreshës zvogëlohen, edhe pas një periudhe të gjatë të parandalimit të vendosjes së vezëve. ●



Nga dashuria për natyrën deri te zhvillimi i biznesit familjar

Është interesante historia e Jasmina Ma dhe rrugëtimi i kthimit në shtëpi, krijimi i një agrobiznesi familjar në natyrën e paprekur të fshatit Matka e Epërme. Jasmin Ma, e lindur në Shkup në një martesë të përzier-nënë serbe, babai irakian, një jetë e mbushur me udhëtime midis Teheranit, Libanit, udhëtimi jetësor në Kinë, kthimi në Maqedoni, Kinë përsëri dhe përsëri Maqedoni, në Matkë, ku me Uran Saitin krijon historinë e vet familjare, punën dhe perspektivën e vet.

Një koncept i angazhuar, i rrumbullakosur biznesi me vizionin e Jasminës dhe Uranit, i cili përfshin jetë dhe prodhim në natyrë dhe nga natyra, duke ushqyer vlerat tradicionale dhe kulturore për një biznes të qëndrueshëm modern.

Vizioni i Jasmina Ma dhe Uranit për biznesin familjar fillon paralelisht me romancën e tyre dhjetë vjet më parë. Dashuria për natyrën, kafshët, ëndrra për një familje të lumtur, jeta në natyrë janë pjesë e krijimit të një biznesi familjar plotësues që e krijojnë këta të rinj. Një rrugëtim i mbushur me shumë mund, entuziazëm, përshtatje-bashkim me natyrën, por me plot dashuri, qëllim dhe energji, një makinë që i tërheq drejt



suksesit. "Në fillim krijuam një bazë për jetën tonë në fshatin Matka e Epërme, mbi fshat në natyrë të paprekur.

Ndërtuam shtëpi, siguroam ujë në një thellësi prej 50 m, blemë dy dhi dhe kështu filloi vizioni ynë familjar, jeta dhe biznesi", tregon Jasmina. Sot Jasmina dhe Urani kujdesen për 40 dhi dhe dy lopë, prodhojnë qumësht dhe djathë dhe Jasmina filloi prodhimin e kozmetikës unike organike, kryesisht me

zgjdhjet e veta inovative. Rruga drejt plasmanit është sfidë, por cilësia e produkteve, zgjidhjet e marketingut, krijimi i një rrjeti komunikimi, promovimi dhe edukimi (i juaji dhe i blerësve), është paketa që dëshmon dhe premtos sukses. Produktet e tyre i shesin onlajn, kurse shpërndarja sigurohet me transportin e tyre në Shkup.

Bimë mjekësore perfekte të natyrës, të shndërruara në kozmetikë organike. Kremra, sapunë, vajra organike, të prodhuar nga përbërës natyralë dhe barëra të marra nga pjesët më të thepisura malore të Matkës. "Zgjidhni natyrën, porositni rininë. Pse duhet të përdorim kremra me aditivë kimikë kur kemi burime natyrore që na adhurojnë?", është mesazhi i Jasmina Ma, artistes që e zbaton artin e saj në një linjë prodhimi të kozmetikës organike. Kremra organike për fytyrën të krijuar me kujdes me dyllë blete të përpunuar në mënyrë natyrale, të kombinuara me kalendula për lëkurë të ndjeshme, livandë qetësuese për çdo ditë, barozë kundër plakjes, propolis dhe dru çaji për aknet dhe krem nate me vaj limoni jeshil, kalendula dhe kamomil, luleradhiqë. Të gjitha janë 100% organike me vitamina të shtuara, vajra esencialë francezë, vajra macerate të prodhuara nga Jasmina. Kurse në planin e biznesit familjar të Jasminës dhe Uranit, prodhimi i djathit dhe qumështit të dhisë dhe lopës, vezëve pulash, thëllëzash, felafer, krem, djathë i tymosur, peshk i tymosur, ftua i ëmbël... Matka është e fuqishme, plot energji, kurse e tillë janë edhe kozmetika natyrale e Jasminës dhe e gjithë linja ushqimore natyrale e familjes Saiti.

Iletë për zgjerimin e biznesit të tyre rural po shumohen vazhdimisht. Vizita e një delegacioni nga Federata Nazionale e Fermerëve, ambasadores amerikane Anxhela Ageler dhe ministrit të Bujqësisë, Pylttarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, Ljupço Nikollovski në shtëpinë e tyre, i inkurajon këta të rinj që të zgjerojnë biznesin e tyre rural dhe me qëllime turistike që do të përfshijnë një sërë komponentësh mbi një koncept agrokulturor - ushqim shtëpiak, shëtitje edukative në Matka, punëtori për prodhimin e kozmetikës natyrale, shitje.

Këta të rinj sot janë rrëfim i suksesshëm, inspirativ nga çdo kënd. ●



Rrethet e studimit janë pritur shumë mirë nga të rinjtë



Antoneta Zaja e lindur më 25 shtator të vitit 1983, në Dom, Pukë. Studimet e larta i ka kryer në Universitetin "Luigj Gurakuqi", në Shkodër, dega gjuhë-letërsi. Ka punuar si mësuese e kësaj lënde prej 18 vitesh, në shkollën "Nikoll Lleshi", Gjegjan, Pukë, ku vazhdon edhe tani të ushtrrojë profesionin. Antoneta është një shembull i qartë që tregon se si gratë rurale luajnë një rol kyç në familjet dhe komunitetet e tyre. Nëse u jepen mundësi të barabarta dhe qasje në burime, gratë rurale mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në zhvillimin ekonomik në Shqipëri.

Prej shumë vitesh Antoneta është anëtare e shoqatës Agropuka duke u angazhuar në një sërë trajnimesh dhe

iniciativash të ndryshme me fokus fuqizimin e grave rurale. Që nga viti 2014 ajo është angazhuar në metodologjinë e njohur "Rrethet e Studimit", praktikë e cila ka rezultuar e suksesshme në zonën e saj. E trajnuar si lidere e rrethit studimor, ajo çdo vit ka organizuar tematika të ndryshme me të rinjtë e zonës, ku të gjithë kanë përfutur informacione dhe njohuri të vlefshme në fusha të ndryshme jetësore.

Rrethet e studimit janë pritur shumë mirë nga të rinjtë. Mund të evidentoj si histori suksesi dhomën kulturore të realizuar në Gjegjan, në vitin 2015. Kështu e pashë të arsyeshme ta zgjeroj si metodologji në sektorin ku unë kam më shumë njohuri, atë të bimëve mjekësore.

Shqipëria ka rreth 350 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike që rriten kryesisht në zonat malore të vendit, të cilat përbëjnë një burim ekonomik natyror të rëndësishëm, ende të pashfrytëzuar plotësisht dhe në mënyrën e duhur ku ndër më të njohurat mund të përmendim sherbela, balsami, rigoni, boronica, qershia e egër, livanda, trumza, bima e maktshit, e deri tek hithra, ciani, trëndafil i egër dhe shtogu. Prandaj, qëllimi i krijimit të këtij rrethi studimor ka ardhur nga nevoja për të kuptuar efektin që kanë përdorimi i përditshëm e bimëve mjekësore në jetën tonë.

